KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi,TM2 2023

04.08.2023

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi, TM2 2023
Ky publikim Ky publikim është i bazuar në grumbullimin e çmimeve të prodhimeve bujqësore vendore në Kosovë. Grumbullimi i të dhënave është bërë në treg, ferma dhe vendet të tjera, ku çmimet e prodhimeve bujqësore mund të grumbullohen.

Prodhimet, të cilat krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore janë ndarë në dy grupe kryesore: Prodhimet bimore dhe ato blegtorale. Në kuadër të prodhimeve bimore, çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë foragjere, perime, patate dhe pemë. Në prodhimet blegtorale çmimet janë grumbulluar për blegtorinë dhe prodhimet blegtorale. Në kuadër të blegtorisë, çmimet grumbullohen për katër kategori të kafshëve: gjedhe, dele, derra dhe pula. Këto çmime janë bazuar në peshën e gjallë të kafshëve. Në kuadër të prodhimeve blegtorale çmimet janë grumbulluar për: qumësht, vezë dhe mjaltë. Të gjitha çmimet janë llogaritur në Euro dhe njësitë matëse janë në: kg, litër dhe copë.

Indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore, blegtorale dhe totali i prodhimeve bujqësore TM2 2015-2023, (2015=100)



Përshkrimi	TM2 2015	TM2 2016	TM2 2017	TM2 2018	TM2 2019	TM2 2020	TM2 2021	TM2 2022	TM2 2023
Prodhimet bimore	**122,5**	**124,1**	**122,2**	**117,3**	**125,3**	**134,4**	**126,1**	153,9	176,1
Prodhimet blegtorale	**98,6**	96,8	100,8	101,2	104,1	112,3	104,7	128,6	144,6
Totali prodhimeve bujqësore	105,0	104,1	106,5	105,5	109,8	118,2	110,4	135,4	153,0

Vërehet një rritje në tremujorin e dytë të vitit 2023 krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2022

Në tremujorin e dytë të vitit 2023, indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale ka rritje për (12,4%), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022. Kurse, indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore ka rritje për (14,4%).

Ndërkaq, Indeksi i përgjithshëm i prodhimeve bujqësore ka rritje për (13,0%), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022.

Përshkrimi	TM2 2022	TM2 2023	Ndryshimi në %
Prodhimet bimore	153,9	176,1	14,4
Prodhimet blegtorale	128,6	144,6	12,4
Totali prodhimeve bujqësore	135,4	153,0	13,0

Për më shumë informata lidhur me Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi, për TM2 2023 (2015=100